

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

Rendi i Ditës

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Lëvizjes Socialiste për Integrim, për shkelje të parashikuar në vendimin nr.9 datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj zotit Arben Qalliu me funksion përgjegjës i Zyrës së Kadastrës Lushnje

PJESËMARRJA :

Ilirjan	CELIBASHI	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Stafi	KQZ	Y.Merkaj, E.Meta, L.Mavriqi
Zoti Arben Qalliu		

Z.I.Celibashi: Mirëdita të gjithëve, fillojmë sot seancën publike “për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Lëvizjes Socialiste për Integrim për shkelje të parashikuar në vendimin nr.9 datë 24.12.2020, Komisioni Qendror të Zgjedhjeve ndaj zotit Arben Qalliu me funksion përgjegjës i Zyrës Kadastrës Lushnje.

Zoti Arben Qalliu është prezent, në këtë shqyrtim administrativ. I japim fjalën Sekretarit për ta relatuar si çeshtje.

Z.Y.Merkaj: Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve na ka ardhur denoncimi në një faqe të aktiviteteve të ndaluara. Kallzo, për veprimtarinë e deputetit të PS-së, Qarkut Fier zotit Bujar Çela, me datën 28.10.2020, i cili ka publikuar në llogarinë e tij personale në facebook disa foto me qytetarë të ndryshëm duke shpërndarë leje legazimi të shtëpive të tyre në Njësinë Administrative Hysgjokaj. Sipas denoncuesit kjo veprimtari bie ndesh me nenin 3, paragrafi 1...shkronja “a” e vendimit nr.9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, i cili e parashikon si veprimtari të ndaluar shpërndarjen në veprimtari publike për këto leje të legazimit në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Bazuar në këtë vendim denoncuesi

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KOZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

pretendon që deputeti e ka të ndaluar të kryejë veprimtari të tilla siç është ndarja e lejeve të legazimit, e cila sipas ligjit është detyrë funksionale e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi denoncimin dhe në verifikim paraprak të të dhënave, konstatoi se referuar nenit 1 nën paragrafi 3 shkronja "a", veprimtari të ndaluara janë edhe ato veprimtari që përfshihen në shpërndarjen dhe në veprimtari publike të lejeve të legazimit në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Referuar nenit 3 paragrafit të parë nën paragrafin .. shkronja "b" ndalohet shpërndarja në veprimtari të ndaluara të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore çertifikatave të pronësisë ose çfarëdo lloj titulli pronësie sipas legjislacionit, përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë si dhe regjistrimin e titujve të pronësisë sipas ligjit 111 të vitit 2018 për Kadastrën në periudhën 4 muaj para ditës së zgjedhjeve. Në rast së Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kryesisht ose me kërkesë konstaton se veprimtaria publike **përkon** veprimtari të ndaluara, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike përkatëse. Referuar nenit 30 paragrafi i dytë i Vendimit nr.9 të vitittë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili përcakton rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, të cilët gjatë periudhës 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo lloj forme në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij Vendimi. Në veprimtarinë publike të deputetit Bujar Çela nuk është raportuar asnjë veprimtari e tillë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës apo Drejtoria Vendore Lushnje nën juridiksionin e së cilës është edhe Njësia Administrative Hysgjokaj. Fakti që një funksionar publik ka shpërndarë leje legalizimi, arsyeshëm dëshmon se funksionari nuk ka funksion zyrtar të drejtojnë apo të shpërndajë dokumente të cilat nuk prodhohen nga vetë ai ose ajo. Në këto kushte dokumenti i lëshuar në këto veprimtari është dokument i prodhuar dhe në zotërim të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

drejtpërdrejt të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnje nën juridiksionin e të së cilës është edhe Njësia Administrative Hysgjokaj. Në këto kushte Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve mund të fillojë procedurën administrative bazuar në indiciet e denoncuesit për shkak të kompetencës ndaj subjektit, të cilit i ngarkohet përgjegjësia për shkeljen e parashikuar në nenin 3 pika “a”, paragrafi i dytë i Vendimit nr.9, 2010. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në dt. 07.01.2021 ka njoftuar z. Arben Qalliu për të zhvilluar seancë dëgjimore në bazë të nenit 47 dhe... të ligjit për Ligjin e Procedurave Administrative. Komisioneri bazuar në nenin 80 të Kodit të Procedurave Administrative, i kërkon z. Arben Qalliu të japë shpjegime lidhur me këto pyetje.

Z.I.Celibashi: Faleminderit. Sikurse u relatua edhe nga sekretari, z. Qalliu, ne kemi marrë një kallzim nga një subjekt politik në lidhje me procesin e shpërndarjes së lejeve të legalizimit në territorin e Njesisë Administrative të Bashkisë Lushnje. Në njoftimin që ju kemi dërguar për t’u paraqitur në seancën e sotme dëgjimore, ju kemi kërkuar që për sa është e mundur nga ana juaj, brenda këtyre ditëve mund t’i jepni tani shpjegimet në lidhje me, nëse Njësia Administrative Hysgjokaj është nën juridiksionin e Drejtorisë Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Lushnje. Në muajin Dhjetor 2020 në periudhën e denoncimit të faktit, sa çertifikata pronësie apo edhe leje legalizimi janë lëshuar nga kjo drejtori vendore, pra nga zyra juaj. E treta çertifikatat e pronësisë ose lejet e legalizimit gjatë kësaj periudhe, kur janë dhënë dhe në çfarë mënyre u janë dorëzuar aplikantëve, pra nëpërmjet sistemit E-albania, me postë, dorazi, në sportel e të tjera si këto. Dhe në përgjithësi çfarë mund të informoni ju këtu në lidhje me procesin e dhënies së çertifikatave së pronësisë ose të lejeve të legalizimit në mënyrë të posaçme nga data 25 dhjetor 2020 e në vazhdim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

Faleminderit!

Fjala është për ju.

Z.A.Qalliu: Përshëndetje, unë jam Arben Qalliu, drejtues i ASHP Lushnje për një periudhë afërsisht 4 muaj e gjysmë nga sot. Në lidhje me problemin në fjalë në fillim dua të sqaroj pjesën që ndoshta nuk është një informacion nga ju si institucion, por kam lexuar në portale se kam qenë prezent me deputetin që gjatë kohës që ka dalë foto me banorët. Kjo është një gjë që shumë mirë e faktoni me fotot që ndodhen në facebook, unë nuk kam qenë pjesë në terren për të dalë fotografi me qytetarët. Në lidhje me pyetjen tuaj të parë, Njësia Administrative Hysgjokaj është një pjesë e territorit të Bashkisë Lushnje, që përfshin Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Lushnje. Pra, ASHP Lushnje përfshin dy bashki, Bashkinë e Lushnjës dhe Bashkinë Divjakë. Hysgjokaj është një nga vijat administrative që ndodhet në zonën e territorit të Bashkisë Lushnje. Pyetja ime ishte konkrete sesa është totali i lejeve. Nuk e di totali i lejeve për një muaj apo totali i lejeve sepse ne prodhojmë leje çdo muaj. T'ju ve pak në dijeni, në ASHP funksionon kështu: nga data 1 deri në datën 20 të çdo muaji ne punojmë në lidhje me procedurën e përpunimit të dosjeve dhe pas datës 20 të çdo muaji deri në datën 30, që është 10-ditëshi i fundit ne bëjmë emërtimin ose printimin e lejeve të legazimit. Ne vetëm në 10-ditëshin e fundit kemi të drejtën ligjore të printojmë leje, pasi dhe sistemi hapet në atë 10-ditësh nga zyra qendrore. Për periudhën Nëntor, nëse do të marrim totalin mund të jenë printuar afro 130 leje legalizimi për dy bashki, për Bashkinë Lushnje dhe Bashkinë Divjakë. Mënyra e dërgesës... kjo është shumë e rëndësishme që unë dua ta shpjegoj....

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

Z.I.Celibashi: Ne nuk e kemi për momentin numrin e çertifikatave ose lejet e legazimit që janë shpërndarë për muajin Dhjetor. Pavarësisht procedurës..

Z.A.Qalliu: Janë prodhuar në muajin Nëntor, shpërndarja dhe sot që flasim.....

Z.I.Celibashi: Janë prodhuar, si të thuash zyrtarisht ka dalë leja.

Z.A.Qalliu: Po, ka dalë leja në Nëntor, 130 është një shifër mund të jetë 127,131 po flas te kjo shifër.

Z.I.Celibashi: Dhe sa prej tyre janë shpërndarë? E kemi këtë informacion?

Z.A.Qalliu: Mund të jenë shpërndarë jo më shumë se 40% e tyre.

Z.I.Celibashi: Faleminderit!

Z.A.Qalliu: Pasi një pjesë e lejeve që prodhojnë qëllonjë që janë emigrantë edhe ne nuk i dorëzojmë, sepse ato kanë një afat 45 ditor nga momenti që u vete leja e legalizimit qytetarit për pagesën e truallit për të përfituar atë bonon 30% që është në ligj. Gjithsesi ajo që dua t'ju them është shumë e rëndësishme, mënyra e dërgesës. Aluizmi dhe Hipoteka dikur kanë funksionuar vecmas dhe ishte shumë e thjeshtë, pasi ti merr lejen e legazimit nga Aluizmi.... për të bërë regjistrimin e kësaj. Me krijimin e ASHK-së e cila bën shkrirjen e mundshme të Aluizmit të Hipotekës na ka ndodhur një fenomen shumë i rëndësishëm që duhet vënë në dukje. Fakti që një pjesë e qytetarëve që marrin leje legazimi, mendojnë që ka përfunduar procesi i tyre i marrjes së tyre të pronësisë dhe nuk vijnë ta regjistrojnë për të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

marrë çertifikatën e pronësisë. Pra është një titull pronësie, por nuk është përfundimi. Përfundimi është kur ti lejen e legazimit e regjistron në hipotekë dhe ka më shumë leje legazimi të marra që nga fillimi i ASHK-së që qytetarët mendojnë se del nga një institucion që është Hipoteka dhe Aluizmi, e mbajnë në shtëpi lejen e legazimit e nuk vijnë ta regjistrojnë. Lejet e legalizimit funksionojnë në një formë të tillë. Për një pronë ne pritojmë 3 leje legazimi, një karton ose një leje merr qytetari, një leje rri në dosjen e lejes së legalizimit, një leje që është dublikatë vazhdon procesi i regjistrimit në sektorin e hipotekës. Pra pavarësisht se leja e legalizimit ka dalë, anëtari nuk e ka marrë. Ne vazhdojmë e bëjmë regjistrimin me kufizim deri në momentin që bën pagesën për të aplikuar për t'u regjistruar. Zgjidhja ime që kam menduar sa jam drejtues këto 4 muaj e gjysmë por edhe më përpara ka funksionuar në dy forma: një formë është në sportel te qytetari, i cili vjen e merr lejen e legalizimit pas kontaktit që bëjmë me telefon, merr dhe sqarimin e nevojshëm që kjo leje e legazimit nuk mjafton me kaq, por ti duhet të bësh një aplikim nga dita e regjistrimit të kësaj leje legalizimi dhe një formë tjetër është: unë të paktën e kam zgjidhur një grup të terrenit, kam disa grupe terreni të cilat bëjnë dhe matjet në terren të aplikantëve. Unë personalisht në ASHK-në që drejtoj, veprojmë në formë të tillë: i hyj një fshati të tërë për çështjen e legalizimit, nuk merrem me raste sporadike Hysgjokaj, kam topografët që bëjnë matje vazhdimisht. Në fillim bëjnë informimin e qytetarëve, në rastet kur ata nuk kanë aplikuar dhe në rastin kur kanë aplikuar vazhdojnë procedurën më tej, në qoftë se i mungon një deklaratë noteriale, çertifikatë familjare bazuar në dosje që kanë. Rastet konkrete të paktën në muajt e fundit për arsye të Covidit sipas një udhëzimi nga zyra qendrore, ne i kemi mbyllur sportelet për të mos krijuar fluks. Në fakt kam një muaj e pak që kam mbyllur dhe pritjen e qytetarëve, pasi në ASHK-në Lushnje nga fundi i muajit Shtator deri sot që flasim ne kemi përditë raste pozitive

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

të punonjësve dhe për të mos e krijuar më të vështirë procesin, qoftë me punonjësit qoftë me qytetarët e kam mbyllur sportelin pranë ASHK-së sime dhe komunikimin me qytetarin e kam ose virtual me telefon ose me anën e grupeve të terrenit që kam. Kam 3 grupe terreni që shpërndaj nëpër Njësi Administrative. Konkretisht leja e legalizimit me ndryshim nga çertifikata e pronësisë është një dokument i cili kërkon të dorëzohet te qytetari, informacion që ai duhet të vijë të aplikojë te E-Albania e qytetarit për të bërë regjistrimin e kësaj leje legalizimi. Ndërsa çertifikatat e pronësisë në ndryshim nga leja e legalizimit kanë një veçanti tjetër që qytetari të vijë te ne apo të vijmë ne te ai, pasi te E-Albania e vet, te dokumentat e mia i vjen e vetmja mënyrë e firmosur e çertifikatës së pronësisë. Prandaj lejen e legalizimit ka shumë interes që specialisti im, pasi ta ketë dorëzuar ta sqarojë se çfarë duhet të bëjë në hapat në vazhdim, ndërsa çertifikata e pronësisë është shumë e thjeshtë, mjafton që ai të bëjë një aplikim te E-Albania dhe çertifikata i dorëzohet në rrugë elektronike te adresa e qytetarit dhe ai e konfirmon nga telefoni i vet dhe nuk ka nevojë fare të vijë tek ne. Ky është një informacion i plotë që dua të jap. Kurse informacioni konkret lidhur me çfarë janë publikuar në faqen e deputetit, unë kam marrë dokumentet e nevojshme, që vërtetojnë se këto leje legalizimi janë të zonave të tjera Kadastrale i kam dorëzuar me një urdhër të brendshëm timin në proces-verbal të mbajtur nga punonjësit e mi të terrenit të çdo qytetari në shtëpi duke marrë firmën e çdo qytetari që ka marrë në dorëzim lejen e legalizimin. Nëse më kërkohet një informacion shtesë, më thoni.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Nuk e kuptuam shumë qartë, ju e keni një shpjegim se si këto çertifikata janë gjendur në dorën e deputetit?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

Z.A.Qalliu: Shpjegimin mund ta jap diku tjetër shumë mirë. Fakti që unë nuk kam qenë i shoqëruar me deputetin, shpjegimi është shumë i thjeshtë. Unë punoj në zonat kadastrale në një fshat të tërë dhe aktualisht unë jam në zonën kadastrale Hysgjokaj, ai vazhdimisht është në terren, Unë këtë muaj po punoj në një zonë që ai e mbulon politikisht dhe ky është një informacion që ai mund ta dijë. Pra ai nga unë nuk ka marrë asnjëherë leje legalizimi, që ia kam dhënë dorazi unë vetë deputetit asnjëherë.

Z.I.Celibashi: Nga informacionet që ne kemi, rezulton që këto lejet e legalizimit janë shpërndarë nga deputeti. Pyetja është si ka mundësi që kjo leje legalizimi e cila lidhet me një interes personal, të cilit që ai ka aplikuar gjendet në dorën e një subjekti një personi të tretë. Nëse keni një shpjegim për këtë?

Z.A.Qalliu: Shpjegimi është ky që mendoj unë. Nga fillimi i muajit deri në fund të muajit jam i përqendruar me një zonë kadastrale në një fshat dhe ai është në dijeni që për këtë muaj vazhdimisht prodhoj leje dhe punoj për ... për zonën Hysgjokaj dhe ai gjendet në terren mund të pyesë qytetarët ose mund të kenë qëlluar aty çunat, që kanë bërë shpërndarjen e lejeve si specialistët e mi dhe ka qenë në terren. Por të ketë ardhur në zyrën time apo ta kem takuar unë personalisht apo institucioni që unë administroj deputetit e t'i them ... për lejen e legalizimit bëje ti shpërndarjen se unë nuk di ta bëj, se më takon mua ta bëj unë s'e kam bërë.

Z.I.Celibashi: Nuk e ka thënë askush, as ne nuk e themi nuk mund ta provojmë dot e nuk verifikohet. Ajo çfarë ne jemi duke thënë dhe kërkojmë të qartësohet e sqarohet ka të bëjë me faktin që në procedurën e marrjes së lejes së legalizimit apo dhe të certifikatës së pronësisë. Është një marrëdhënie terësisht bilaterale, e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

dyanshme e atij që është e atij që aplikon dhe i autoritetit publik që e ofron shërbimin e kryen aplikimin dhe përgjigjen e aplikimit e marr po unë direkt apo jo. Kjo është procedura dhe ajo çfarë mund të ketë funksionuar dhe kështu, por ne nuk e dimë këtë, duket që këto certifikatat nuk i kanë shkuar drejt për së drejti personit, aplikuesit por në një mëyrë i ka shkuar një të treti, ua ka dhënë atyre në dorë ose mund të jetë dhe kjo tjetra, për hir të vërtetës. Ju ua keni dhënë qytetarit, pastaj qytetarët ua kanë dhënë prapë deputetit e i kanë thënë na e shpërndani ju, mund të funksionojë dhe kështu. Normalisht do të duhet se x qytetar bën aplikimin, ju marrëdhënien e keni drejt për së drejti me të ose ndërmjet postës ose ndërmjet platformës. Një pyetje të fundit, ju thatë që keni mbyllur sportelin? Nuk ofroni më shërbime në sportel? Në kushtet që është mbyllur sporteli si e bëni dorëzimin, si e bëni grumbullimin?

Z.A.Qalliu: Nga krijimi i Akdizës në Lushnje sepse jo të gjitha qytetet kanë akdisa, por ne kemi akciza që janë krijuar më pak se një vit nga krijimi i akdisës, të gjitha sportelet janë mbyllur për pjesën e aplikimeve, pra aplikimet bëhen ose në akdisa ose pranë ndonjë noteri ose qytetari nga smartphoni i tij. Nga periudha e aplikimit të akdisës deri në periudhën që u bë situata kaotike në lidhje me pandeminë në sportel kisha një specialist vetëm për informacion, ai sqaronte qytetarët. Kishte raste që vinte qytetari për të marrë lejen e legazimit, ia dorëzonte me firmë te libri i protokollit. Pra sporteli ynë ka funksionuar vetëm për informacion dhe për dhënie leje legalizimi, ndërsa të gjitha aplikimet e tjera funksiononin me anë të akdisës ose me anë të noterëve.

Z.I.Celibashi: Sot çfarë ndodh, certifikatat që do të shpërndani në Janar, në fund të muajit sikurse thatë, si do ta bëni shpërndarjen e tyre?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

Z.A.Qalliu: Situatën e kam të rënduar sot për arsyen e Covidit, vazhdoj me urdhër të brendshëm, i nxjerr grupet e terrenit që bëjnë dhe matjet në terren, bëjnë dhe dorëzimet e lejeve të legalizimit, bëjnë dhe informimin e qytetarëve që pasi ka marrë lejen sot hajde nesër te akdisa të bëjë aplikimin për të marrë certifikatën. Pasi bën aplikimin për te akdisa për të marrë certifikatën e kësaj leje, nuk vjen më te unë se certifikata vete në mënyrë elektronike te platforma E-Albania që ka qytetari, që hapet te akdisa që nuk e ka hapur.

Z.I.Celibashi: Pra leja e legalizimit ndahet në proces-verbal nga punonjësit?

Z.A.Qalliu: Vetëm leja, se proceset e tjera bëhen nga E-Albania. Leja ka ngelur akoma fizikisht pasi është tjetër pronësie dhe qytetari i merr dorazi, të gjitha procedurat e tjera bëhen me aplikim.

Z.I.Celibashi: Në rastin konkret a mund të ketë ndodhur që këto punonjësit tuaj të mos kenë bërë detyrën ashtu sic duhej dhe nuk i kanë shpërndarë lejet e legalizimit personalisht cdo aplikanti, por ia kanë lënë deputetit duke i thënë shpërndaje ti. Mund të ketë qëlluar kështu?

Z.A.Qalliu: Jo nuk besoj se ai ka marrë firmën qytetarit dhe atë nuk i kanë gjetur të gjithë qytetarët bashkë në një vend. Më kupton ai ka vajtur nëpër familje, kanë bërë matje në terren.

Z.I.Celibashi: Po thoni që deputeti ka qëlluar rastësisht në të gjitha këto?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

Z.A.Qalliu: Mund të ketë qëlluar rastësisht dhe mund të ketë shkuar të nesërmen është i nteresuuar është aktiv nga ana politike në pjesën e vet për favore politike ose për pjesën e tij që unë nuk dua të hy fare. Ai ka dalë publikisht në këto leje legalizimi, por këto leje legalizimi janë dhënë qytetarëve, u është marrë firma dhe i është dhënë nga specialistët që kam unë në terren. Një pjesë kanë ardhur jo për muajt në vazhdim, por i kanë marrë vet te sporteli.

Z.I.Celibashi: Faleminderit!E mbyllim seancën e shqyrtimit nëse nuk kemi gjë tjetër për të shtuar. Ndonjë dokumentacion e keni me vete?

Z.A.Qalliu: Po, e kam një kopje të njësuar të urdhërit që kam nxjerrë për grupin e terrenit, kam dhe një kopje të proces-verbaleve jo vetëm të një zone, por të gjitha zonave të tjera ku unë kam bërë shpërndarjen e lejeve të legalizimit. I kam të regjistruara i keni këtu proces-verbale. Keni dhe një kopje të listës bashkëlidhur të qytetarëve që u kanë marrë firmën. Dua të veçtoj se bashkëlidhur keni një kopje të të gjitha lejeve të legalizimit të këtij muaji për zonën e Hysgjokajt, të cilat vërtetohen kollaj. Të gjitha këto leje janë prodhuar në Nëntor dhe unë javën e parë të çdo muaji bëj dorëzimin e këtyre lejeve të atyre që janë një pjesë e madhe emigrantë, legalizimet nuk janë aq të rëndësishme sa mendohej. E shoh që njerëzit nuk kanë shumë interes, ndoshta dhe për faktin se nuk kanë shumë lidhje, që po lodhen po strapacohen, por interesi i lejeve të legalizimit nuk është aq i madh sa po mendohej e sa po bëhej politikisht dhe unë e ndjej, i lutem njerëzve që vetëm hajdeni nuk janë të regjistruar ose nuk janë mosbesues.

Z.I.Celibashi: Këtë nuk e themi dot..

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.01.2021, ora 12:00*

Z.A.Qalliu: Që të përdorësh një leje legalizimi politikisht nuk është një meritë e madhe mendoj unë.

Z.I.Celibashi: Faleminderit për shpjegimet tuaja, faleminderit dhe për dokumentacionin e prezantuar. E mbyllim seancën e dëgjimit dhe tërhiqemi për të marrë vendim. Do t'ju njoftojmë për vendimin. Nuk do ta shpallim sot se do të shqyrtojmë dhe dokumentacionin që keni paraqitur. Do t'ju njoftojmë. Faleminderit për të gjitha shpjegimet e dhëna.

Seanca mbyllet dhe do të njoftoheni për seancën e vendimit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,
të dat.14.01.2021 ora 13:00*

14.01.2020

Ora 13:00

RENDI I DITES

**Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Lëvizjes Socialiste për Integrim,
për shkelje të parashikuar në vendimin nr.9 datë 24.12.2020, të Komisionit
Qendror të Zgjedhjeve ndaj zotit Arben Qalliu me funksion përgjegjës i Zyrës së
Kadastrës Lushnje**

PJESËMARRJA :

- Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Jorgaqi, E.Meta
- Parti Politike

Z.I.Celibashi: Mirë atëherë çelim sot seancën publike, për shqyrtim e kërkesës së subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim. Kjo ka si objekt denoncimin e faktit të shpërndarjes së lejeve të legalizimit nga një deputet në Bashkinë e Lushnjes. Proçedura administrative e cila e konsistoj në njoftime dhe thirrjen e drejtorit të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës të Drejtorisë Rajonale Lushnje, Z.Arben Qalliu, Zoti Sekretar ka marrë dijeni për seancën sot?

Z.Y.Merkaj: Po është njoftuar, është njoftuar edhe nga telefoni im, ka kthyer përgjigje, ju falenderoj që më njoftuat por nuk do marri pjesë.

Z.I.Celibashi: Mirë atëherë meqënëse shqyrtimi u përfundua në seancën e kaluar dhe seanca e sotme konsiston vetëm administrimin e të gjitha fakteve të shqyrtuara në seancën e kaluar, në përfundim të shqyrtimit të këtyre fakteve dhe pretendimeve të paraqitura dhe nga drejtuesi i Drejtorisë Rajonale të Agjensisë Shtetërore të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,
të dat.14.01.2021 ora 13:00*

Kadastrës Lushnje. Rezulton që i provuar fakti se një funksionar publik Deputet ka shpërndarë leje legalizimi në territorin që ka në juridiksion Drejtoria Rajonale e Agjensisë Shtetërore së Kadastrës Lushnje. Mbi këtë fakt komisioneri shtetëror ka administruar provat e grumbulluara dhe rezulton që kjo është një përgjegjësi, shpërndarja e këtij dokumentacioni e këtyre certifikatave është përgjegjësi direkte e drejtorit të Drejtorsë Rajonale Lushnje të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës dhe rezulton që veprimtaria dhe veprimet e kryera nga drejtuesi i Drejtorisë Rajonale Lushnje janë në kundërshtim me përcaktimet e ninit 29-të ligjit ku thuhet që çdo shërbim kadastral kryhet vetëm pas dorëzimit të një kërkesë dhe kërkesa është një formular tip që gjendet në sportelet e shërbimit online. Nenit 91 pika 1 të Kodit Zgjedhorë ku përcaktohet se nuk mund të perdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve të partive politike ose koalicionëve zgjedhore, burimet e organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendorë apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit pavarësisht nga burimi i kapitalit. Drejtuesi Rajonal i Agjensisë Shtetërore ë Kadastrës Lushnje nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar se veprimtaria e tij në lidhje me këtë fakt prezantuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim është kryer në përputhje me ato protokolle të cilat i ka përcaktuar ligji për kadastrën. Gjithashtu rezulton që veprimet e kryera nga ky drejtues dhe stafi në varësi të tij kanë kontribuar në lëshimin e dokumentave zyrtare për qytetarët në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Kadasën duke krijuar mundësi që kështu subjektet politike, për interesat e tyre ta kryejnë këtë proces pra në kundërshtim me ato përcaktimet e ligjit. Prandaj për këto arsye Komisioneri Shtetëror bazuar në nenin 19 pika 1 shkronja n 2 dhe nenet 91, 92, 171 pika 2 të ligjit nr.10.019-të datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhorë i Republikës së Shqipërsë i ndryshuar në nenin 3

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,
të dat.14.01.2021 ora 13:00*

paragrafi 2, të vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator dhe nenet 17, 18, 19, të ligjit nr. 10.279 datë 20.05.2010 për Kundravajtjet Administrative

Vendosa:

Të dënoj me gjobë Z.Arben Qalliu me detyrë drejtor i Drejtorisë Vendore Lushnje në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës me shumën e 1500 lekëve (njëmijë e pesëqind lekë) për shkelje të nenit 92 të Kodit Zgjedhorë. Ky vendim përbën titull ekzekutiv, dhe kundër këtij vendimi mund të behet ankim, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3(tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hy në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së, faleminderit seanca mbyllet!

Vendimi nr. 7

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*

